



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.94/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve “Best Trade”, N.E. nga Shtimja dhe NTP “Internacional” me seli ne Prishtinë, ndaj debitorit NLP “Pallati i Rinisë” Shpk, me seli ne Prishtinë i përfaqësuar nga Korab Rexhepi avokat nga Prishtina rr.”Nënë Tereza”, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorëve NTP “Internacional” dhe N.E., të paraqitur kundër aktvendimit te Gjykatës Themelore ne Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.512/19 datës 26.09.2019, me date 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorëve NTP “Internacional” me seli ne Prishtinë dhe N.E. nga Shtimja, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore ne Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.512/19 i datës 26.09.2019, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore ne Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.512/19 dt.26.09.2019 , ka aprovuar si ta bazuar kërkesën e debitorit NLP “Pallati i Rinisë” Shpk, me seli ne Prishtinë te datës 15.03.2019, me te cilën ka kërkuar eliminimin e parregullsive te bëra nga Organi Përmbarues ne çështjen përmbarimore P.nr.774/14 dhe P.nr.1005/15 si dhe Anulohen Konkluzionet P.nr.774/14 i datës 21.12.2018 dhe P.nr.1005/15 i datës 21.12.2018, për caktimin e ekspertizave dhe lëndët i kthehen përmbaruesit Privat Afet Mjeku ne ri procedim, gjegjësisht caktimin e ekspertizave te reja sipas Aktgjykimeve ASC-09-0101 dt.13.09.21012 dhe ASC-09-0084 dt.13.09.2012

Kundër këtij atij aktvendimi, kanë ushtruar ankesë kreditorët NTP “Internacional”, dhe N.E., për shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj si te bazuar ankesën dhe aktvendimin e shkallës së parë ta anuloj ndërsa urdhrat e përmbaruesit privat ti lë në fuqi.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i debitorit, duke i kundërshtuar si të pabazuara pretendimet ankimore të kreditorëve, me propozim që gjykata ta refuzoj ankesën e kreditorëve si të pabazuar dhe ta vërtetoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorëve është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorët “Best Trade”, “N.E. nga Shtimja dhe NTP “Internacional” me seli ne Prishtinë, kanë ushtruar propozim për përmbartim, ndaj debitorit NLP “Pallati i Rinisë” Shpk, me seli ne Prishtinë, në bazë të dokumentit përmbartimor vendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme ASC-09-0101 dt.13.09.2012 dhe ASC-09-0084 dt.13.09.2012. Gjykata Themelore ne Prishtinë ka lejuar përmbartimin me aktvendimin E.nr.341/13 dt.24.07.2013 në bazë të dokumentit përmbartimor, i vërtetuar dhe i plotfuqishëm nga Gjykata e Apelit të Kosovës me AC.nr.2374/13 dt.03.12.2013 dhe Konkluzionin P.nr.1005/15 dt.21.12.2018 të lejuar nga Gjykata Themelore ne Prishtinë E.nr.1599/2011 dt.24.07.2014 të vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin Ac.nr. 3522/2014 dt.04.06.2015. Me aktgjykimet ASC-09-0101 dt.13.09.2012 dhe ASC-09-0084 dt.13.09.2012 gjykata ka përcaktuar kamatën në lartësinë prej 3.5% vjetore. Përmbartuesi Privat ka vazhduar me veprime procedurale me çka ka ndryshuar kamatën e përcaktuar me Aktgjykimet e Gjykatës Supreme –Dhomës së Posaçme, ashtu që me Konkluzionin P.nr. 774/14 dt.21.12.2018 ka kalkuluar kamatën prej 8 % ndryshe nga ajo 3.5% vjetore e përcaktuar me aktgjykimet e Gjykatës Supreme-Dhomës së Posaçme.

Gjykata Themelore ne Prishtinë më Konkluzionin PPP.ne.512/19 dt.12.04.2019 e ka urdhëruar Përmbartuesin Privat Afet Mjeku nga Prishtina që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita pranimit të këtij Konkluzioni t’ia dorëzoj Gjykatës të gjitha shkresat e lëndës P.,nr.774.14, P.nr.1005/15 dhe P.nr./1032/15. Përmbartuesi Privat me datën 25.04.2019 i ka dorëzuar gjykatës lëndet përmbartimore si me lartë. Gjykata Themelore ne Prishtinë ka gjetur se Përmbartuesi Privat kishte caktuar Ekspertizë Financiare për llogaritjen e kamatës dhe atë në këtë mënyrë: nga data 26.02.2000 deri me datën 31.12.2012 të llogaritet kamata vjetore prej 3.5% ndërsa për periudhën prej 01.01.2013 deri me 21.12.2018 të llogaritet kamata vjetore prej 8% për shumën prej 480,000.00 euro për kreditorin NTP “Internacional” Prishtinë, ndërsa me konkluzionin P.nr.1005/15 dt.21.12.2018 kishte caktuar Ekspertizë Financiare për llogaritjen e kamatës dhe atë nga data 26.02.2000 deri me 31.12.2012 të llogaritet kamata vjetore prej 3.5% ndërsa për periudhën prej 01.01.2013 deri me 21.12.2018 kamata vjetore prej 8% për shumën prej 180,000.00 euro për kreditorin N.E. nga Shtimja dhe nga data 26.02.2000 deri me datën 31.12.2013 të llogaritet kamata vjetore prej 3.5 % ndërsa për periudhën prej 01.01.2013 deri me 21.12.2018

kamata vjetore prej 8% për shumën prej 80,000.00 euro për kreditorin NTP “Internacional” Prishtinë.

Debitori NLP “Pallati i Rinisë” përfaqësuar nga avokat Korab Rexhepi ka paraqitur kërkesë për eliminimin e parregullsive të bëra nga Organi Përmbaues me pretendimin se Gjykata Supreme e Kosovës me vendimet e saja ASC-09-0101 DT.13.09.2012 dhe ASC-09-0084 dt.13.09.2012 ka gjykuar kamatën në lartësi prej 3.5% dhe atë në shumën e gjykuar, dhe se Konkluzioni i Përmbauesit Privat P.nr.774/14 dt.21.12.2018 dhe P.nr.1005/145 dt.21.12.2018 për përpilimin e ekspertizës janë nxjerr në kundërshtim me Aktgjykimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës sepse është dashur që kamata të llogaritet ashtu siç është paraparë me aktgjykim.

Gjykata Themelore në Prishtinë pas analizimit të kronologjisë së veprimeve, ka nxjerr aktvendim PPP.nr.512/2019, me të cilin ka aprovuar kërkesën e debitorit NPL “Pallati i Rinisë” për eliminimin të parregullsive të bëra nga Organi Përmbaues në çështjen përmbaimore dhe ka anuluar Konkluzionet P.nr.774/14 dt. 21.12.2018 dhe P.nr.1005/15 dt. 21.12.2018 duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit. Në arsyetim të vendimit të saj ka konstatuar se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës ka nxjerr aktgjykimet ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084 dt.13.09.2012 dhe ka vendosur meritorisht, ashtu që nuk i lë hapësirë përmbauesit privat e as gjykatës që të aplikoj ndonjë interpretim ligjor tjetër për një çështje të gjykuar. Gjykata Supreme është instanca më e lartë gjyqësore në Republikën e Kosovës, ashtu që nuk do kishte kurrfarë kuptimi që aktgjykimet e gjykatave të mos zbatoheshin. Shton se aktgjykimet e Gjykatës Supreme janë finale dhe nuk mund të vihen në pikëpyetje, këto çështje janë vendosur në mënyrë meritore dhe të njëjtat prodhojnë efekt juridik ashtu siç parashihen në Aktgjykim. Gjykata ka rekomanduar që Përmbauesi privat në rivendosje të kësaj çështje të nxjerr konkluzione duke caktuar një ekspertizë financiare e cila do ta bën llogaritjen e kamatës sipas Aktgjykimeve ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084 dt.13.09.2012 dhe pas kësaj çështje të procedon sipas dispozitave të LPP, ndërsa sa i përket kërkesës fillestare të debitorit lidhur me përjashtimin e përmbauesit privat si dhe kërkesës lidhur me lenden P.nr.1032/15 të kreditorit NGB Zëri gjykata këto kërkesa nuk i ka shqyrtuar pasi me parashitjen e të autorizuarit të debitorit me datën 28.05.2019 ka hequr dorë nga kërkesa për përjashtim të përmbauesit ndërsa me parashitjen e datës 26.08.2019 e ka korrigjuar kërkesën e tij në raport me lëndën Pnr.1032/15 të kreditorit “NGB Zëri” duke kërkuar me këtë përmbaimit mos të behet shqyrtimi pasi kjo lëndë e ka përfunduar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr vendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar se vendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbaimore dhe kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe është zbatuar e drejta materiale, kështu që mund

të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e këtij urdhri, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbareme me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se Organi Përmbareme me rastin e kalkulimit dhe ndryshimit të normës së kamatës në lidhje me obligimet e debitorit ndaj kreditorëve, ka tejkaluar kamatën e propozuar të kreditorëve dhe kamatën e përcaktuar me aktgjykimet ASC-09-0101 dt.13.09.2012 dhe ASC-09-0084 dt.13.09.2013 të nxjerra nga Gjykata Supreme e Kosovës – Dhoma e Posaçme, e cila me aktgjykimin e saj ka vendosur që norma e kamatës në lidhje me çështjen përmbareme në procedurë të jetë 3.5% vjetore, dhe se këto vendime të Gjykatës Supreme të Kosovës janë dokumente përmbareme të formës së prerë në bazë të cilave është lejuar përmbaremi.

Dhomat e shkallës së dytë sa i përket pretendimeve të kreditorëve i vlerësoj si të pabazuara dhe se të njëjtat nuk kanë ndikuar për një vendosje tjetër të gjykatës, sepse këto pretendime nuk i kanë argumentuar me prova konkrete ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP dhe si të tilla i refuzon si të pabazuara.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha më lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.94/22 me datë 04.06.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha